

RREGULLA PER SEZONIN E VJESHTES 2019-2020

Këto rregulla janë unike për studentët e viteve të fundit në të gjitha ciklet e studimit: PP, BA, MP dhe MSC të cilët në sezonin e verës nuk mundin të shlyenin të gjitha detyrimet dhe nuk u diplomuan:

- Viti I MP (60),
- Viti II MP (90);(120)
- Viti II MSC
- Viti II Prof 2-vjec
- Viti III Bachelor

Për sezonin e vjeshtës 2019-2020 studentët duhet të regjistrohen vetë në lëndët që do të japin provim.

Më poshtë tregohen rregullat dhe procedura e regjistrimit në sezonin e vjeshtës 2019-2020.

1. Sipas strukture të miratuar nga Rektori ky sezon vjeshte (vetem për studentet që diplomoheshin në korrik) është: 3 shtator - 14 shtator 2020.
2. Sa ditë sezoni do të jenë në vjeshtë ?.....(10)
Datat e Sezonit të Vjeshtës janë: 3-4-5-7-8-9-10-11-12-14 shtator 2020.
3. Për një lëndë të caktuar sa data provimesh do të lihen ?.....(1)
4. Në sa provime mund të futet studenti në një ditë ?.....(deri në 2 provime)
5. Sa provime gjithsej mund të japë studenti në sezonin e vjeshtës?.....(14)
6. Studenti mund të prenotohet vetëm një herë për të njëjtin provim.
7. Për sezonin e vjeshtës regjistrimi i studentëve duhet të bëhet nga 1 shtator – 2 shtator 2020.
8. Pas kësaj date asnjë student nuk mund të kryejë veprime për regjistrime në provimet e sezonit të vjeshtës.
9. Në provimet e vjeshtës nuk mund të futen studentët që s'kanë bërë pagesën për vitin akademik 2019-2020 apo kanë pagesa të prapambetura nga vitet akademike të kaluara .
10. Të gjithë studentët të cilët kanë patur lëndë të pafrekuentuara gjatë viteve të mëparshme akademike, por që i kanë frekuentuar ato në vitin akademik 2019-2020 duhet të verifikojnë në sistem nëse pedagogu i lëndës i ka vendosur frekuentimin përndryshe studenti nuk mund të regjistrohet dot në këtë provim për sezonin e vjeshtës 2019-2020.
11. Kujtojmë se për tu regjistruar në sezonin e vjeshtës të gjithë studentët duhet të kenë frekuentuar lëndët përkatëse dhe të jenë të pajisur me të dhënat që ata kanë vendosur vetë, për të hyrë në sistemin digjital.
12. N.q.s studentët kanë problem me këto të dhëna atëherë të komunikojnë sa më shpejt me sekretaritet mësimor të fakultetit përkatës për tu njohur me to.
13. Manuali për regjistrimin në provimet e sezonit të vjeshtës do të mund ta shkarkoni dhe nga websiti i universitetit: <http://www.unkorce.edu.al>.